



Lista e pritjes e përqendruar Kushtet dhe informacione të përgjithshme

Përkufizim

Lista e pritjes e përqendruar (*Liste d'attente centralisée* - LAC) përfshin tërësinë e kërkesave për një vend pritjeje për fëmijët nga 0-6 vjeç në pritje kolektive dhe të fëmijëve nga 0-12 vjeç në pritje në mjedis familjar.

Zyra e informimit të prindërve (*Bureau d'information aux parents* - BIP) i përqendron kërkesat dhe merr përsipër t'i trajtojë ato dhe t'i kalojë në LAC, sipas rendit të mbërritjes.

Kushtet për të pasur një vend në Rrjetin-L (Réseau-L)

Regjistrimi në LAC mund të bëhet :

- nëse fëmija është me banim në bashkinë e Lozanës ;
- qysh nga muaji i katërt i shtatzënisë ;
- e shumta një vit para datës së pritjes të dëshiruar ;
- 6 muaj para vendosjes me banim në Lozanë (adresa duhet të jetë e njohur) ;
- 6 muaj para marrjes në punë nga një ndërmarrje partnere me Rrjetin-L ;
- për pritjen pas mësimit, vetëm nëse fëmija frekuenton një institucion shkollor bashkiak

Dosja e regjistrimit

Regjistrimi bëhet vetëm përmes formularit Kërkesë për një vend pritjeje ditore (*Demande de place d'accueil de jour*), të cilit prindi ose prindërit e fëmijës duhet t'i bashkëngjisin dokumentet e mëposhtme, sipas gjendjes :

- fishën e fundit të rrogës dhe/ose
- borderonë e fundit të arkës së papunësisë dhe/ose
- vërtetimin e AVS-së (Sigurimi për pleqërinë dhe të mbijetuarit) për të pavarurit dhe/ose
- vërtetimin që konfirmon ndjekjen e një formimi certifikues.

Data e regjistrimit në LAC

Data e regjistrimit përkon me datën në të cilën BIP-ja merr dosjen e plotë të kërkesës : formularin e regjistrimit dhe vërtetimet.

Nëse prindërit nuk e pranojnë një vend që përkon krejtësisht me ditët e kërkuara që figurojnë në LAC, data e regjistrimit në LAC do të përditësohet me datën e mospranimit.

Përcaktimi i strukturave të pritjes

Vendbanimi i fëmijës që figuron në Kontrollin e banorëve (*Contrôle des habitants*) përcakton institucionet e fëmijërisë (*Institutions pour l'enfance* - IPE) të interesuara prej kërkesës. Në rast se mbajtja e fëmijës është e ndarë midis dy prindërve, prindi me banim në Lozanë mund të bëjë kërkesën pranë BIP-së për ditët e tij të mbajtjes, edhe nëse fëmija banon jashtë Lozanës.

BIP-ja merret edhe me regjistrimet e familjeve që banojnë jashtë Lozanës të cilat përfitojnë nga një vend pritjeje në gjirin e Rrjetit-L nëpërmjet punëdhënësit të tyre (grupi klient). Këto familje nuk mund të kenë qasje në shërbimet e pritjes familjare ditore (AMIFA), me përjashtim të punonjësve/seve të Qytetit.

Përqindja dhe ditët e frekuentimit

Përqindja dhe ditët e frekuentimit përshtaten me përqindjen e zënies me punë dhe ditët e punës efektive të prindit ose prindërve.

Me kërkesë të DIPE-së, prindi ose prindërit duhet të dorëzojnë një vërtetim të punëdhënësit lidhur me ditët e punës efektive.



Konfirmimi i regjistrimit

Pas trajtimit të kërkesës, BIP-ja u transmeton prindërve një konfirmim të regjistrimit, duke përfshirë të dhënat e IPE-ve që mund ta presin fëmijën e tyre dhe, sipas kërkesës, edhe ato të AMIFA-së. Prindërit mund t'u kërkojnë BIP-ve që të përjashtojnë një apo disa struktura nga lista e tyre. Në asnjë rast, kjo përçapje nuk jep të drejtë për IPE shtesë, jashtë sektorit të banimit.

Kohëzgjatja, përditësimi dhe ripërtëritja e një regjistrimi në LAC.

Regjistrimi në LAC është i vlefshëm 6 muaj. Gjatë kësaj periudhe, prindërit kanë përgjegjësinë për t'i transmetuar BIP-së çdo informacion të dobishëm për përditësimin e kërkesës së tyre (ndryshim adrese, modifikim të përbërjes familjare apo të gjendjes profesionale...)

Jo më shumë se 15 ditë para fundit të vlefshmërisë së regjistrimit, prindërit duhet të ripërtërijnë kërkesën e tyre pranë BIP-së me anën e dokumentit Kërkesë aktualizimi (*Demande d'actualisation*) duke bashkëngjitur vërtetimet e reja.

Në mungesë ripërtëritjeje, regjistrimi çaktivohet automatikisht. Nëse këkesa për një vend qëndron gjithmonë, atëherë prindërit duhet të bëjnë një kërkesë të re.

Kriteret e përparësisë sipas motivit të kërkesës

Për plotësimin e kushteve të vëna nga Ligji i 20 qershorit 2006 mbi pritjen ditore të fëmijëve (*Loi cantonale du 20 juin 2006 sur l'accueil de jour des enfants* - LAJE ; 211.22), BIP-ja ka vënë kriteret përparësie që bazohen mbi motivin e kërkesës të bërë nga prindërit në momentin e regjistrimit dhe që zbatohen nga IPE-të gjatë dhënies së vendit. Me rend përparësie :

Pajtimi

Kriteri i *pajtimit midis jetës familjare dhe jetës profesionale* pranohet kur prindërit apo prindi (në rast familjeje njëprindërore) vërteton me dokumente se punon ose ndjek një formim të çertifikuar ose se përfiton nga pagesat e papunësisë.

Parandalimi

Kriteri i *parandalimit* pranohet në rast nevojshmërie për një mbështetje të posaçme për zhvillimin e fëmijës dhe/ose për shoqërimin në ushtrimin e rolit të prindit. Këto arsye duhet të vërtetohen me certifikatë.

Shoqërizimi

Kriteri i shoqërizimit pranohet për çdo kërkesë kur një prind është në një qendër strehimi ose ushtron një veprimtari vullnetare ose nuk i ka motivet e përmendura në pikat e mësipërme.

Kur një prind jeton me një shok ose me një shoqe, përcaktimi i këtyre kriterëve mban parasysh gjendjen e të dy partnerëve nëse ata/ato janë të martuar/a ose kanë një fëmijë sëbashku ose deklarohen si bashkëjetues/e ose jetojnë nën të njëjtën çati qysh prej të paktën 5 vjetëve.

Nëse fëmijës i është dhënë një vend tashmë, në rast ndryshimi të kriterit të përparësisë nga "pajtim" në "shoqërizim", DIPE-ja mund të vedosë për shkurtimin e kontratës, madje edhe anulim e saj .

Elemente të tjera që marren parasysh gjatë dhënies së një vendi

Dhënia e një vendi mban parasysh edhe nevojat e institucionit pritës për t'u organizuar, duke marë në konsideratë elementet e mëposhtme :

- moshën e fëmijës (grupet foshnja, ata që nuk janë çuar ende në këmbë, mesatarë ose nxënës) ;
- ditët e frekuentimit të kërkuara ;
- prania në strukturë e një anëtarit të vëllazërisë.

Dhënia e një vendi

Dhënia e një vendi është vetëm në kompetencën e drejtorive të IPE-ve të cilat i kontaktojnë drejtpërdrejt prindërit për t'ua propozuar vendin.

Riregjistrimi në LAC

Riregjistrimi në LAC për një fëmijë që e ka tashmë një vend në gjirin e Rrjetit-L pranohet vetëm në këto katër raste :



- për të plotësuar kohën e mbajtjes së fëmijës në rast të një kërkesë të plotësuar pjesërisht ;
- për shkak transferimi me banesë në një lagje tjetër të qytetit ;
- kur familja dëshiron të kalojë nga pritja familjare ditore në pritjen kolektive ose e kundërta ;
- kur familja dëshiron ta kalojë fëmijën nga një strukturë e lidhur me punëdhënësin e tyre në një strukturë të lagjes së tyre të banimit ose e kundërta.